

SHKUPI

LAJMËTARI INFORMATIV I QYTETIT TË SHKUPIT

NUMËR PA
PAGESE

СКОПЈЕ

Numër 5 Viti II 29.05.2009

BASHKËRISHT PËR SHKUPIN E PASTËR DHE TË GJELBËRUAR

MARATONI I SHKUPIT 2009

**TUMBA MAXHARI -
SHTËPIA E NËNËS SË MADHE**



„SHKUP“

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
„Shkupi“ u botua më:
10 dhjetor 2008

Del çdo të mërkurë të tretë të
muajit

Kryeredaktor
Nedelço Krstevski

Zëvendës kryeredaktor
Lupço Pandilovski

Redaksia
Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Redaktor i fotografisë
Radomir Jovanović

Perkthyes dhe lektorë
Vlladimir Bogdanovski, Behar Dalipi,
Sadije Dalipi, Merita Abdullahi

BOTON QYTETI I SHKUPIT
për botuesin
Kryetari i Qytetit
Koce Trajanovski
Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon
02 3297 255
02 3297 265

e-mail adresa
mediumi@skopje.gov.mk
gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni:
Evropa 92 - Koçanë



Të nderuar bashkëqytetarë,

Jemi në fillim të rrugës së re katërvjeçare, në fillimin e mandatit tim katërvjeçarë si Kryetarë të Qytetit të Shkupit gjatë së cilit do të punoj me zell që të përdëtoj besimin që e fitova prej Jush në zgjedhjet lokale. Pres që së bashku ta ndërtojmë ardhmërinë e qytetit tonë, t'i respektojmë dhe kultivojmë vlerat e krijuara në të kaluarën, të hapërojmë në kohën e tashme dhe se do të punojmë për të ardhmen.

Vizioni im për qytetin e Shkupit është real. Ai bazohet mbi shqyrtime reale dhe në bisedat e shumta konstruktive.

Së pari po mobilizohemi që ta pastrojmë qytetin prej mbeturinave, prej deponive të zeza si dhe prej barojave të larta. Po i mobilizojmë të gjithë qytetarët që aksionet tona për pastrimin e qytetit të Shkupit t'i pranojnë si aksione me iniciativë të tyre dhe kështu në mënyrë aktive të kontribuojnë për një ambient më të pastër dhe më të shëndetshëm për të jetuar, në të cilin ambient të gjithë ne do të jetojmë dhe do të krijojmë së bashku. Qyteti i Shkupit është qyteti ynë, por i yni është edhe obligimi që ta ruajmë dhe mirëmbajmë higjienën. Në këtë drejtim, edhe një herë u angazhuam në aksionin – “Bashkërisht për Shkupin e pastër dhe të gjelbëruar” në këtë aksion do t'i pastrojmë të gjitha dhjetë komunat e qytetit të Shkupit, kurse përmes kontakteve të drejtpërdrejta me qytetarët do ta përcjellim idenë për një ambient më të pastër që do të duhet të jetë imperativ për çdo qytetarë.

Parësore do të jenë orvatjet për evitimin e kaosit që mbretëron në komunikacion si dhe

përpilimi i zgjidhjeve të reja të komunikacionit që do të ndihmojnë që qytetarët të arrijnë më shpejtë në destinacionet e synuara.

Tani më po i shqyrtojmë të gjitha projektet e filluara në qytet dhe të gjitha qasjet që janë në interes dhe në dobi të qytetarëve të Shkupit do të vazhdojnë dhe do të kryhen. Me qëllim që në kohë të përfundojnë obligimet e ndërmarra nevojitet që të mirëmbahet stabiliteti financiar i Qytetit të Shkupit dhe të sigurohen burime plotësuese të të ardhurave. Është e domosdoshme që të bëhet rebalanci i Buxhetit të Qytetit të Shkupit për vitin 2009 që të ndahen prioritetet dhe të ruhet rejtingu kreditor i Qytetit.

Qëllimi ynë është që të organizojmë një administratë të denjë, serioze dhe të përkushtuar, e cila do të filloj t'i realizoj premtimet e dhëna, por njëkohësisht do të përpiqemi që t'i pranojmë të gjitha idetë kreative dhe nevojat e qytetarëve të Shkupit.

Qytetin do të duhet t'ia kthejmë qytetarëve të Shkupit dhe ta shndërrojmë në një vend të denjë për të jetuar. Do të duhet që qytetin ta largojmë prej pozicionit të një administrate të pafuqishme të qytetit dhe do të duhet që shërbimet e tij të paraqesin një servis i cili do t'u përgjigjet qytetarëve në kohën e duhur dhe me efikasitet. Qytetin e Shkupit do të duhet ta shndërrojmë në një qytet i cili do të jetoj dhe do të zhvillohet si një metropol i vërtetë, duke i kultivuar të gjitha të mirat kulturore, arsimore, sportive dhe urbanistike të kohës së sotme – me një fjalë, të gjitha përfitimet civilizuese të cilat e ndërtojnë identitetin e qytetit të Shkupit.

Përmes modernizimit të shkollave dhe sigurimit të procesit mësimor sipas standardeve më të larta ne do ta rikthejmë dinjitetin e mësimdhënësve, profesorëve, nxënësve dhe studentëve. Duhet të hapërojmë me të arriturat më të reja teknologjike.

Së bashku do të duhet t'i lartësojmë vlerat kulturore dhe trashëgimin tonë natyrore me të cilën ne me të vërtetë mund të krenohemi dhe mund të shfaqemi me dinjitet para gjithë botës.

Duhet të mësojmë që ta ruajmë dhe ta kultivojmë atë që na lanë paraardhësit tanë, ndaj të cilëve kemi një borxh, por edhe të ndërtojmë dhe të lëmë gjurmë për punën që kemi kryer para brezave dhe gjeneratave të ardhme.

Me respekt,
Koce Trajanovski

Qyteti i Shkupit mobilizohet për mjedis më të pastër jetësor

FILLOI AKSIONI I MADH PËR PASTRIMIN E SHKUPIT

Aksioni i madh për pastrimin e Shkupit nën moton „Së bashku për Shkupin më të pastër dhe më të gjelbër“ filloi më 11 maj në lagjen Autokomandë. Ekipet e ndërmarrjeve publike të qytetit “Higjiena komunale”, “Parqet dhe gjerbri-met” dhe “Ujësjellësi dhe kanalizimi” i pastruan deponit e egra, e kositën barin dhe i krasitën kurorat e drunjëve, i fshinë dhe i pastruan rrugët si dhe pastruan kumbullishtat. Këtij aksioni iu bashkangjitën edhe bashkësitë lokale, nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme si dhe banorët e lagjes Autokomandë. Fillimin e aksionit e shënoi Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

Deri më tani, aksioni – “Bashkërisht për Shkupin e pastër dhe të gjelbëruar” është i realizuar në komunat e Gazi Babës, Qendër, Çair, Gjorçe Petrov dhe Karposh.

- Qyteti i Shkupit sot fillon një aksion të madh për pastrimin e qytetit të Shkupit i cili do të realizohet në bashkëpunim me dhjetë komunat e Shkupit. Në iniciativë të Kryetarit të komunës Gazi Babë, z. Toni Trajkovski, ak-



sioni fillon pikërisht prej kësaj komune, nga lagja e Autokomandës. Aksioni do të zgjas tri ditë, e pastaj vazhdojmë në komunën Qendër. Në aksion u përfshinë edhe ndërmarrjet publike të qytetit të cilat angazhuan një numër të mjaftueshëm të punëtorëve për t'i pastruar hapësirat publike të qytetit. Kemi për qëllim që ta pastrojmë qytetin e Shkupit, por edhe

të ngritët niveli i vetëdijes te qytetarët që ta ruajnë dhe të përkujdesen për mjedisin në të cilin jetojnë. Qëllimi ynë është që qytetarët ta ndjejnë personalisht këtë aksion dhe në mënyrë aktive të kontribuojnë për mjedis jetësor më të pastër dhe më të shëndoshë – u shpreh Kryetari i Qytetit të Shkupit Trajanovski, në fillim të aksionit.



Aksioni për pastrimin e Shkupit do të zgjas deri më 13 qershorë dhe do të zhvillohet në bazë të kësaj rradhitje:

Komuna AERODROM

- 21,22,23 maj

Komuna BUTEL

- 01, 02, 03 qershor

Komuna KISELLA VODA

- 08, 09, 10 qershor

Komuna SHUTO ORIZARE

- 11, 12, 13 qershor

Qyteti i Shkupit ishte nikoqir i manifestimit tradicional sportiv

MARATONASIT SRETEN NINKOVIQ DHE MARIJA VRAJIQ JANË FITUESIT E MARATONIT TË SHKUPIT 2009

Në organizim të Maratonit të Shkupit ishin të përfshirë rreth 100 persona për realizimin teknik të tij, 250 vullnetarë si dhe 200 nëpunës të MPB-së. Përgjatë korsisë ishin të vendosura 9 stacione freskuese me ujë dhe katër ekipe mjeksore. Në garat morrën pjesë rreth një mijë garues.

Sreten Ninkoviq nga Serbia në konkurrencën e meshkujve si dhe Marija Vrajiq nga Kroacia në konkurrencën e femrave ishin debutuesit e Maratonit tradicional të Shkupit 2009 i cili u mbajt më 10 maj nëpër rrugët e qytetit.

Në suaza të këtij eventi ndërkombëtar sportiv u zhvilluan katër gara në vrapim: maratona (42.195 km), gjysmë maratona (21.097 km), gara në vrapim në gjatësi prej 5.000 metro dhe gara në 2.000 metro për nxënësit e shkollave fillore. Në kategorinë e gjysmë maratona, vendin e parë në konkurrencën e meshkujve e zuri Hristijan Stoshij nga Serbia, kurse në konkurrencën e femrave vendin e parë e zuri Marija Bogdanovska. Në garën prej 5.000 metrove në konkurrencën e meshkujve vendin e parë e zuri Meriton Hasanaj nga Kosova, kurse në konkurrencën e femrave Simona Trajanovska nga Maqedonia.



Në Maratonën e Shkupit 2009 morën pjesë rreth 1.000 garues nga Maqedonia, SHBA-të, Serbia, Franca, Portugalia, Kroacia, Bullgaria, Hungaria dhe nga Mali i Zi. Në garën prej 5.000 metrove morri pjesë edhe Kryetari i Qytetit të Shkupit, z. Koce Trajanovski, evropambasadori Ervan Fuere, ambasadori i Mbretërisë Holandeze në shtetin në tonë zonja Simone Filipini si dhe drejtori i Agjencisë për sport dhe rinj, z. Dragan Gjurçevski.

- Qyteti i Shkupit do të përpiqet që maratona të mbetet pjesë e traditës sonë, brend – garë e kryeqytetit të Republikës së Maqedonisë, që do të dallohet për nga masoviteti, kualiteti, shoqërimi, argëtimi dhe fryma sportive por edhe për nga aftësia jonë për të organizuar maratone njësoj sikur edhe organizimet më të njohura evropiane dhe botërore të maratonëve. Këto gara vetëm përdëftuan faktin se Maratona e Shkupit dhe qyteti i Shkupit si nikoqir i saj tanimë mund të jenë krenarë për faktin se kjo garë është pjesë e kalendarit të Federatës Evropiane Atletike dhe të Lidhjes ndërkombëtare të Federatave atletike. Qyteti i Shkupit sot festoi në mënyrë sportive duke shënuar Ditën e Evropës por edhe ditën kur u mbajtën dy ngjarjet më të mëdha sportive këtë vit, Maratona e Shkupit dhe Gara ndërkombëtare për automobila në pjerrësi – “Çmimi i Shkupit”. Urimë për fituesit, që demonstruan profesionalizëm, qëndrueshmëri dhe trimëri, veçori që janë shumë të njohura në disiplinën më të njohur të atletikës dhe në sportin marrë në përgjithësi – theksoi Kryetari i Qytetit të Shkupit z. Koce Trajanovski i cili më 10 maj ua ndau medaljet garuesve më të mirë.

Të gjitha garat e “Maratona e Shkupit 2009” u zhvilluan nëpër rrugët e qytetit të Shkupit, kurse në afat prej 5 orëve regjimi i komunikacionit nëpër qytet ishte i ndryshuar. Disa





prej rrugëve ishin tërësi dhe e disa pjesërisht të mbyllura për komunikacion. Edhe linjat e transportit publik urban ishin të ndryshuara.

Fillimi i katër garave u zhvilluan në rrugën Dimitrie Çupovski, afër "Rekord", kurse caku i të gjitha katër garave ishte sheshi "Makedonija".

Gara e maratonit u zhvillua dy qarqe me nga 21 km, përderisa gjysmë maratona u realizua në një qark.

Në organizim të Maratonit të Shkupit u inkuadruan rreth 100 persona në organizimin teknik të tij, 250 vullnetarë si dhe 200 nëpunës të MPB-SHPB-së Shkup dhe policia e trafikut.

Përgjatë korsisë ishin të vendosura 9 stacione freskuese me ujë dhe katër ekiye mjekësore.

Pesë garuesit më të suksesshëm në konkurrencën e meshkujve dhe femrave fituan shpërblime në të holla kurse të gjithë garuesit që përfunduan maratonin dhe gjysmë maratonin fituan medaljone. Shpërblimet në gjësede ishin të parapara për garuesit më të suksesshëm në garën rekreative në gjatësi prej 5.000 metro përderisa gara e organizuar për shkollat fillore nuk kishte karakter garues. Fondi i përgjithshëm

i shpërblimeve në mjete financiare për "Maratona e Shkupit 2009" ishte në vlerë prej 10.000 euro.

Maratona e Shkupit është një eveniment sportiv ndërkombëtarë dhe bën pjesë në kalendarin e Federatës Evropiane të atletikës (EAA) si dhe Lidhjes ndërkombëtare të

federatave atletike (IAAF). Në muajin prill, korsa e maratonit ishte e matur prej personit zyrtarë të IAAF për matje të korsive maratonase, z. Sus Rainer dhe me këtë Maratona e Shkupit përfitoi edhe certifikatin ndërkombëtarë për korsinë e përmendur dhe u bë anëtare e Lidhjes së Maratonëve ndërkombëtare (AIMS).

Maratona e Shkupi organizohet nga Lidhja e sporteve të Shkupit, Federata atletike e Maqedonisë, Komiteti Olimpik i Maqedonisë si dhe Klubi atletik – "Rabotnički". Sponsorë të Maratonit të Shkupit janë Qyteti i Shkupit, Agjencia për sport dhe të rinj të Republikës së Maqedonisë si dhe Misioni i Bashkimit Evropian.

Maratona e parë është mbajtur në vitin 1997. Vitin e ardhshëm është realizuar edhe një edicion të këtij manifestimi sportiv dhe më pas ka pushuar kjo traditë. Në vitin 2007, në iniciativë të Qytetit të Shkupit dhe të evroambasadorit në Maqedoni, z. Ervan Fuere, u organizua gara në gjysmë maratonë në gjatësi prej 21 kilometra. Pas organizimit të suksesshëm të kësaj ngjarjeje dhe pas jehonës së madhe që pati e njëjta, organizatorët vendosën që në vitin 2008 të përsëritet Maratona e Shkupit dhe të mbahet për çdo vit tradicionalisht.

PRONONCIME

„Me organizimin e Maratonit të Shkupit i cili po mbahet tradicionalisht në metropolin tonë po popullarizohen aktivitetet fizike përkundër mënyrës së re dhe dinamike të jetuarit që prej nesh kërkon qëndrueshmëri më të madhe fizike. Me kënaqësi mund të konstatoj se masoviteti dhe pranimi i këtij eventi, shërben si dëshmi për nevojën gjithnjë e më të madhe për ndryshimin e stileve të jetës të banorëve të qytetit tonë që të merren me sport dhe të argëtohen.

Sporti paraqet bazë për zhvillimin e drejtë të rinjve, që paraqet edhe përpjekjet tona që përmes aktiviteteve sportive t'i llogojmë të rinjtë prej vese të ditëve të sotme...”, Koce Trajanovski, Kryetari i Qytetit të Shkupit.

Duke mbajtur llogari për zhvillimin dhe popullarizimin e sportit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Agjencia për sport dhe rinj, po përpiqen që të afrohen drejtë rrjedhave bashkëkohore dhe botërore për avancimin e sportit në shtetin tonë. Maratona e Shkupit edhe zyrtarisht u bë brend me përmasa botërore me anëtarësimin në AIMS (Lidhja e maratonëve ndërkombëtarë). Me këtë manifestim kultivojmë praktikën që edhe te ne të organizohen eventimente masovike sportive të llojit të tillë ku do të marrin pjesë garues të gjeneratave më të reja por dhe garues të gjeneratave më të moshuara. Por ne nuk do të ndalemi këtu, do të vazhdojmë me projektet që Agjencia për sport dhe rinj i ka parapara për t'i realizuar në periudhën e ardhshme me qëllim që qytetarëve të Maqedonisë t'ua afrojmë sa më shumë sportin. Shpresoj se ky manifestim sportiv do sjell masovitet edhe më të madh sportiv, fer – plej dhe shoqërim...”, Dragan Gjurgevski, drejtor i Agjencisë për sport dhe të rinj.

„Ekzistojnë më shumë arsye për të cilat njerëzit preferojnë vrapimin – për shkak të ushtrimeve dhe për të tejkaluar stresin, që të ndjehen mirë dhe me shëndet, që të tejkalojnë ndonjë sëmundje ose që vetes t'i përdëftojnë diçka. Por cila do që të jetë arsyeja, rezultati final çdoherë është pozitiv – është mirë për disponimin, për shpirtin dhe për trupin. Vrapimi i afon njerëzit pa dallim të racës, përkatësisë etnike, prejardhjes ose moshës së tyre. Maratona e Shkupit është një manifestim sportiv për të cilën shpresojmë se do të vazhdojë të tërheq sa më shumë njerëz nga e tërë Evropa.

Për herë të parë Maratona e Shkupit është e inkuadruar në Lidhjen e maratonëve ndërkombëtarë, duke pozicionuar kështu qytetin e Shkupit në kartën e garave të Evropës.

Mbani mend, është me rëndësi që të merrni pjesë dhe të arrini deri te caku në këmbë dhe me buzëqeshje në fytyrë!”,evroambasadori Ervan Fuere.



Jetë më e mirë në qytete

KARTA QYTETARE EVROPIANE

Karta Qytetare Evropiane e miratuar më 18 mars 1992 në Kongresin e pushtetevet rajonale dhe lokale të Këshillit të Evropës përbën një udhëzues praktik për menaxhim të mirë me qytetet, duke përcaktuar të drejtat e qytetarëve në qytetet evropiane. "Karta Qytetare Evropiane" i është dedikuar zhvillimit dhe konceptit të qytetit në Evropë dhe elementeve të jetës së qytetit (demokraci lokale, politikë urbane, bashkëpunim ndërmjet qyteteve, të drejtat në qytete). Në kartë janë përgatitur në mënyrë të hollësishme principet në të cilat duhet të bazohen të gjitha aspektet individuale të jetës së qytetit, si: transporti dhe lëvizja, ambienti jetësor dhe natyra në qytete, formimi i pamjes vizuale të qytetit, pasuria arkitektonike e qyteteve, ndërtimi i banesave, siguria qytetare dhe preventiva ndaj kriminalitetit, sporti dhe rekreimi, kultura, personat me handicap dhe të kërcënuar, shëndetësia,

integrimi multikulturor, planifikimi urbanistik, participimi qytetar dhe zhvillimi ekonomik i qyteteve. Me këtë, karta identifikon një numër të caktuar principesh universale bazë, të cilat mund të zbatohen lehtë nga ana e vendeve evropiane, qytetet e të cilave ballafaqohen me probleme të ngjashme sipas natyrës dhe volumit.

Karta udhëhiqet nga besimi se qytetarët kanë të drejta qytetare bazë: e drejta për mbrojtje nga agresioni, nga ndotja, nga ambient rrethues i pakëndshëm dhe shqetësues, e drejta për zbatimin e kontrollit demokratik në vetëqeverisjen lokale të tyre, e drejta për hapësirë dinjitoze për banim, shëndet, mundësi kulturore dhe lëvizje. Në këtë kontekst, Karta insiston në atë që të drejtat të zbatohen për të gjithë qytetarët në qytet, pa diskriminim gjinie, moshe, origjine, race, besimi, social-ekonomik ose gjendjeje politike, mangësi

fizike ose psikike.

Duke bashkuar në të njëjtin tekst këtë varg principesh për administratë qyteti të mirë në nivel lokal, qëllimi i Kartës është të sigurohet vegël praktike dhe udhëzues për administratën e qytetit të pushtetit lokal.

Karta Qytetare Evropiane është rezultat i punës së Këshillit Evropian për politikë urbane e inspiruar nga Fushata Evropiane për rinovim qytetar në periudhën 1980-1982. Kjo fushatë, e cila ishte pasqyrim i mendimit të pushtetit lokal dhe popullatës nëpër Evropë për pika kyçe të caktuar për përmirësimin e jetës në metropole, ishte fokusuar në katër fusha kryesore të përgjithshme: përmirësimi i ambientit fizik qytetar, rinovimi i fondit banesor ekzistues, krijimi i mundësive shoqërore dhe kulturore në qytete dhe zhvillimi i bashkësisë dhe pjesëmarrja e publikut. Slogani i fushatës ishte "Jetë më e mirë për qytetet."

ÇFARË BOTON SHTYPI

Dnevnik 14 prill 2009

TRAJANOVSKI EDHE ZYRTARISHT KRYETAR I QYTETIT



këshilltarëve të rinj, ju dëshiroi punë të suksesshme dhe u shpreh se me të do të kenë bashkëpunim konstruktiv.

Në marrjen e funksionit të ri, krahas kryetarit të deritanishëm Kostovski, morën pjesë edhe anëtarët e këshillit të vjetër dhe të ri të Qytetit të Shkupit, drejtorët gjeneral të ndërmarrjeve publike, drejtorët e institucioneve kulturore, si dhe përfaqësues të sindikatave të ndërmarrjeve publike të Shkupit.

Kryetari i ri i Shkupit dje edhe zyrtarisht e morri funksionin nga kryetari i mëparshëm Trifun Kostovski. Nuk ka kryetar qyteti të suksesshëm pa administratë dhe ndërmarrje publike efikase. Secilit që do ta kryejë profesionalisht punën, do t'i jepet mundësi të përsoset dhe të kontribuojë në funksionimin e Qytetit — deklaroi Trajanovski në pranim — dorëzimin solemn. Ai ju uroi mandatin

Gazeta "Veçer" 14 prill 2009

ZYRTARISHT ËSHTË DORËZUAR FUNKSIONI KRYETARË I QYTETIT TË SHKUPIT

Koce Trajanovski edhe zyrtarisht u bë baba i qytetit

...Në mesditë, z. Trajanovski e pranoi funksionin prestigjioz — Kryetarë i Qytetit të Shkupit vetëm pas pesëmbëdhjetë minuta bisedë në kabinetin e Kryetarit të Qytetit me paraardhësin e tij dhe më pas edhe me ceremoninë e organizuar në Këshillin e Qytetit në të cilën morën pjesë anëtarët e përbërjes së vjetër dhe përbërjes së re të Këshillit, drejtorët e ndërmarrjeve publike, drejtorët e institucioneve kulturore dhe të shkollave të mesme, përfaqësuesit e organizatave sindikale, të punësuarit në Kuvendin e qytetit dhe një numër i madh i të ftuarve. Kostovski iu falënderua për bashkëpunimin e mirë kurse Kryetarit të ri i dëshiroi punë të suksesshme në katër vitet e ardhshme. Koce Trajanovski iu falënderuar z. Kostovskit për solemnitetin e organizuar për nder të tij dhe iu uroi mandatin këshilltarëve të rinj.

- Shpresoj se do të kemi bashkëpunim të mirë në të ardhmen për arsye se bashkarish duhet ta vazhdojmë luftën për më shumë kompetenca, për pavarësi më të ma-

Konstituohet Këshilli i ri i Qytetit të Shkupit

IRENA MISHEVA ZGJIDHET KRYETARE E KËSHILLIT



Përbërja e re e Këshillit të Qytetit të Shkupit më datën 24.04.2009 mbajti seancën e parë konstituive. Në seancë u verifikuan mandatet e 43 anëtarëve të Këshillit, ndërsa dy anëtarëve, për shkak të mungesës me arsye, mandatet do tu verifikohen në seancën e parë të ardhshme në të cilën do të marrin pjesë. Kryetar i ri i Këshillit të Qytetit të Shkupit është zgjedhur Irena Misheva, nga grupi këshilltar i VMRO-DPM-NE dhe koalicionit "Për Maqedoni më të mirë".

- Shpreh mirënjohjen time të madhe deri te qytetarët e qytetit tonë nga të gjitha dhjetë komunat për përkrahjen e dhënë dhe për Ju, kolegë këshilltarë, për besimin e dhënë. Shpresoj se ky Këshill do të punojë me sukses për interesat e bashkëqytetarëve tanë, - deklaroi Irena Misheva, pas zgjedhjes për kryetar të Këshillit të Qyteti të Shkupit.

Para përbërjes së re të Këshillit të Qytetit të Shkupit mori fjalën edhe kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

- Këshilltarëve të rinj të Këshillit dhe kryetares së re të porsa zgjedhur Irena Misheva ju uroj zgjedhjen. Jam shumë i kënaqur nga konstituimi me sukses i Këshillit të ri të Qytetit të Shkupit. Tani para nesh shtrohet detyra e punës me përgjegjësi për të justifikuar besimin e qytetarëve dhe për të tejkaluar mospajtimet nëpërmjet një pune konstruktive në Këshill dhe në komisione — theksoi kryetari Trajanovski, në seancën konstituive.



dhe financiare të vetëqeverisjes lokale. Për secilin që në mënyrë profesionale i kryen detyrat e parapara do t'i mundësohet që të arrij nivel më të lartë të përsosjes profesionale dhe kështu të kontribuoj për funksionim më të mirë të Qytetit të Shkupit, theksoi ai duke potencuar se pret një bashkëpunim të mirë me administratën

Elizabeta Arsovska

Gazeta "Utrinski vesnik" 14 prill 2009

KOCE TRAJANOVSKI ZYRTARISHT KRYETARË I QYTETIT

Trajanovski do të luftoj për rritjen e kompetencave dhe për më shumë mjete financiare

Koce Trajanovski zuri vendin e Kryetarit të Qytetit të Shkupit. Paraardhësi i tij z. Trifun Kostovski dje në mënyrë solemne e pranoi atë në prani të këshilltarëve të përbërjes së vjetër dhe të re, drejtorëve të ndërmarrjeve publike dhe të institucioneve kulturore dhe të administratës së qytetit. Kostovski pas solemnitetit shkoi në objektin "Kermes" kurse Trajanovski në zyrën e tij të re...

...Trajanovski i befasuar nga mënyra e pritjes iu falënderua z. Kostovski për të gjitha projektet që i ka realizuar deri më tani dhe tha se do të orvatet për një bashkëpunim konstruktiv me përbërjen e re të Këshillit.

Na mbetet që të luftojmë për kompetenca më mëdha dhe për më shumë mjete financiare që qytetin e Shkupit ta bëjmë një vend më të mirë për të jetuar, theksoi Trajanovski duke vlerësuar procesin e deritanishëm të decentralizimit si një proces të suksesshëm, por të pamjaftueshëm për një zhvillim të vërtetë.

(S.N)

KËSHILLI

LISTA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË QYTETIT TË SHKUPIT, 2009-2013

1. Hidajete Azizi
2. Josif Andreevski
3. Petre Arsovski
4. Gjonul Bajraktar
5. 5Ali Berat
6. Aleksandar Biçikliski
7. Slobodan Bliznakovski
8. Nikolla Velkovski
9. Ignat Vilarovski
10. Borçe Georgievski
11. Igor Gievski
12. Dragi Davçevski
13. Marjan Dodovski
14. Toni Gjureski
15. Snezhana Iljovska
16. Siljan Jakovlevski
17. Nenad Joksimoviq
18. Daniela Karagjozoska
19. Enver Kaçar
20. Sofija Kunovska
21. Raim Limani
22. Gjorgje Marjanoviq
23. Irena Misheva
24. Qemal Musliu
25. Aleksandar Naumovski
26. 2Antoni Novotni
27. Idriz Orana
28. Halide Palloshi
29. Goranço Paunov
30. Zhaneta Popeska
31. Vlado Popovski
32. Perivoje Raniq
33. Gjorgji Savov
34. Dafinka Sazdova
35. Violeta Simiq
36. Dragica Slavevska
37. Ruse Sokolov
38. Sasho Stefanovski
39. Aneta Stojanovska
40. Mara Stoleska
41. Esmat Rexhepova-Teodosievska
42. Slobodan Ugrinovski
43. Bekim Fazliu
44. Adelina Haskaj
45. Zoran Shapuriq

RRUGË MAGJISTRALE DHE MBLEDHËSE NË KOMPETENCAT E QYTETIT TË SHKUPIT

Bulevarde

ASNOM, Serbia, Nikolla Karev, Goce De-
Içev, Makedonija, Koço Racin, Krste Misirkov,
Sveti Kliment Ohridski, Ilinden, 8 Septemvri,
Makedonska vojska, Aleksandar Makedonski,
Vojvodina, Makedonsko-Kosovska brigada,
Hrvatska, Slovenija, Proletna Ofanziva, Kru-
shevska Republika, Cvetan Dimov, Bosna i
Hercegovina, Crna Gora, Hristijan Todorovski
Karposh, Vodnjanska, Jane Sendanski, 3 Ma-
kedonska brigada, 12 Makedonska brigada,
Vidoe Smilevski -Bato, Fevruarski pohod, Par-
tizanski odredi, Kuzman Josifovski- Pitu dhe
VMRO.

Rrugë:

Metodija Andonov- Çento, Saraj, 15
Korpus, Ognjan Prica (Anton Popov), Franjo
Kluz, Nikolla Karev (tek Stacioni i ri i trenit),
Dimo Haxhi Dimov, Bihaqaska, Vostanička,
Hristo Tatarçev, Narodni heroj, Prvomajska,
Samuilova, Llazar Liçenoski, Dimitrija Çupo-
vski, Mito Haxhivasilev-Jasmin, 11 Oktom-
vri, Zheleznička, Naroden front, Salvador
Aljende, Zagrebska, Koce Metalec, 16 Ma-
kedonska brigada, Dimitar Vlahov, Blagoja
Stefkovski, Maxhari, Shuto Orizari, Xhon Ke-
nedi, 2 Makedonska brigada, Ferid Bajram,
Kemal Sejfulla, Aleksandar Urdarevski,
Butelska, Radishanska, Franklin Ruzvelt,
Skupi, Nikolla Parapunov, Moskovska, Jurij
Gagarin, Kozle, Pero Nakev, Bradfordska,
Gjorçe Petrov, Luka Gerov, Mihail Çakov, Va-
sko Karangelevski, Prohor Pçinski, Serava,
Llazar Trpovski, Mitropolit Teodosij Gala-
ganov, Marshall Tito, Dame Gruev, Vojvoda
Vasil Axhilariski, Stiv Naumov, Belasica, Vasil
Glavinov, Aco Shopov, Belgradska, Inter-
nacionalni brigadi, Boca Ivanova, Alekso
Demnievski, 4 Juli, Sremski front, Lepenec,
Tiranska, Boris Kidriç, Adolf Xhiborovski,
Marko Oreshkoviç, Cetinska, Katlanovska,
Bardovci, Industriska 1, Industriska 2, Dimi-
tar Mitrev, 897, Sveti Prohor Pçinski, Roma-
nija, Juzhna obikolnica Vodno, Ljubljanska,
Inxhikovski pat (pjesë e rrugës S. Mihajlov),
Vele Markov, Zhelezarska, Pere Toshev, Vol-
kovo dhe Kruzhna Gazi Baba.



PARADIMI I MATURANTËVE NË SHESHIN „PELLA”

Rreth një mijë maturantë të shkollave të mesme në qytetin e Shkupit më 15 maj në sheshin „Pella” vallëzuan – „kadrilin” duke përkrahur manifestimin i cili për herë të tretë organizohet nën mentorimin e Qytetit të Shkupit. Manifestimi ndërkombëtarë me titullin „Parada e maturës” u përkrah nga zyra e përfaqësuesit special të BE-së në Republikën e Maqedonisë, të cilin e organizoi Drejtoria për kulturë dhe art në qytetin e Shkupit si dhe klubi i vallëzimeve – „Ritëm plus”.

„Parada e maturës” filloi me defilimin e maturantëve prej Muzeut të qytetit të Shkupit përgjatë rrugës „Makedonija” deri te sheshi „Pella”. Kadrili vallëzues filloi saktë në ora 12, njëkohësisht me maturantët e shteteve të tjera pjesëmarrëse në këtë manifestim ndërkombëtarë.

Në „Paradën e maturantëve” morën pjesë maturantët nga 15 shkolla të mesme të Qytetit të Shkupit: „Rade Jovçevski – Korçagin”, „Nikolla Karev”, „Josip Broz Tito”, „Koço Racin”, „Braça Milladinovci”, „Georgi Dimitrov”, „Dr. Pançe Karagjozov”, „Vasil Anteviski – Dren”, „Arseni Jovkov”, „Cvetan Dimov”, „Llazar Tanev”, „Marija Kiri – Skllodovska”, „Vlado Tasevski”, „Dimitar Vllahov” dh „Orce Nikollov”.

Së bashku me maturantët nga qyteti i Shkupit vallëzuan edhe maturantët e qyteteve të Ohrit, Vele-
sit, Strumicës, Radovichit dhe Valandovës.

MANIFESTIMI „SAKURA” E FESTOI LULËZIMIN E QERSHISË



Nën mentorimin e Qytetit të Shkupit, kurse në organizim të Qendrës për shkathtësitë luftarake japoneze „JKA Samuraj Doxho”, në rrugën Maksim Gorki muajin e kaluar për herë të tretë u organizua manifestimi „Sakura”- festa kombëtare japoneze që feston lulëzimin e qershisë.

Në një ambient të posaçëm, përmes tingujve të muzikës tradicionale japoneze, nën kurorat e lulëzuara të qershive në rrugën Maksim Gorki, qindra vizitorë patën rastin që të përcjellin prezantimin e shkathtësive luftarake japoneze nga ana e disa klubeve nga qyteti i Shkupit si dhe prej Republikës së Maqedonisë edhe atë kendo, iaido, karate dhe xh-xhiku.

Si pjesë e manifestimit „Sakura” u pikturuan kaligrafi dhe u përpunuan origami.

KRYETARI I QYTETIT TRAJANOVSKI REALIZOI TAKIME ME SHUMË AMBASADORË TË HUAJ



ambasadori i Republikës së Francës,
Bernar Valero



ambasadori i Republikës së Turqisë,
Arslan Hakan Okçal



ambasadori i Federatës Ruse,
Vladimir Solocinskij

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski nga marrja e funksionit të kryetarit realizoi shumë takime me ambasadorët e huaj në vendin tonë. Në vizitë zyrtare te Trajanovski erdhën ambasadorja e Mbretërisë së Holandës në Republikën e Maqedonisë, Simone Filipi, ambasadori i Republikës së Bullgarisë Miho Mihov, ambasadori i Federatës Ruse, Vladimir Solocinskij, ambasadori i Republikës së Francës, Bernar Valero, ambasadori i Republikës Popullore të Kinës, Dong Çungfeng,

ambasadori i Republikës së Turqisë, Arslan Hakan Okçal, ambasadori i Spanjës, Hose Manuel Pas Argueres dhe ambasadori i Republikës së Hungarisë në vendin tonë, Ferenc Kekeshi.

Në takimet zyrtare, kryetari Trajanovski dhe ambasadorët biseduan për punën e administratës së qytetit, për eksperiencat nga procesi i decentralizimit, për fuqizimin e zhvillimit ekonomik lokal, për intensifikimin e bashkëpunimit në fushën e investimeve, si dhe për mbrojtjen e

ambientit jetësor.

Në takimet që u mbajtën në kabinetin e kryetarit Trajanovski edhe njëherë u vërtetua angazhimi për bashkëpunim të mëtejshëm dhe të suksesshëm të Qytetit të Shkupit me ambasadat e huaja si dhe me qytetet e vëllazëruara të Shkupit.

Kryetari Trajanovski realizoi takime edhe me shefin e misionit të OBSE-s në vendin tonë, Hoze Luis Herero dhe me drejtorin e NDI-së, Kris Hensho.



shefin e misionit të OBSE-s,
Hoze Luis Herero



ambasadori i Republikës Popullore të Kinës,
Dong Çungfeng



ambasadorja e Mbretërisë së Holandës,
Simone Filipi

LABIRINTI PREJ GARDHIT TË GJALLË - ATRAKSIONI I RI NË PARKUN E QYTETIT



Labirinti prej gardhit të gjallë i destinuar për lojë dhe argëtim për më të rinjtë nën emrin – “Parku holandez”, muajin e kaluar në mënyrë solemne u hap në Parkun e Qytetit. Hapja e “Parkut holandez” u realizua në suaza në shënimit të ditës së Mbretëreshës, festë kjo kombëtare të cilën në mënyrë tradicionale e organizon ambasada e Mbretërisë së Holandës në shtetin tonë.

Shënimi i Ditës së Mbretëreshës, filloi me paradën e çiklistëve që filloi prej sheshit

“Makedonija” i cili përfundoi në Parkun e Qytetit. Në parkun u mbajt një aheng i madh në të cilin para qytetarëve të mbledhur u prezantuan fëmijët pjesëmarrës në “Bylbylin e artë” si dhe shumë yje të estradës.

“Parku holandez” në mënyrë solemne u hap prej Kryetarit të Qytetit të Shkupit z. Koce Trajanovski, ministrin e ambientit jetësor z. Nexhati Jakupi si dhe ambasadori i Mbretërisë Holandeze në shtetin tonë zonja Simone Filipini.

U NËNSHKRUA MARRËVESHJA PËR BASHKËPUNIM ME LIDHJEN E PENSIONISTËVE QYTETIT TË SHKUPIT

Kryetari Koce Trajanovski gjatë takimit me udhëheqësin e Lidhjes së shoqërisë së pensionistëve të Qytetit të Shkupit nënshkruan Marrëveshje për bashkëpunim. Me kontratën janë të konkretizuara në interes të këtij grupi të shoqërisë por edhe në interes të qytetit të Shkupit.

Përfaqësuesit të shoqatave e potencuan besimin se me nënshkrimin e marrëveshjes do t’u ndihmohet në fushën e zgjidhjes së disa të drejtave sociale, të drejtat pensionale - invalide si dhe të drejtat e sigurimit shëndetësor. U kërkua edhe rritja e përfaqësimit të tyre në trupat e Qytetit të Shkupit dhe të komunave, kur do të diskutohet për çështjet që i tangojnë pensionistët.

Duke shprehur përkrahjen për punën e Lidhjes, Kryetari i Qytetit z. Trajanovski, dha urdhëresë deri te shërbimet e Qytetit të Shkupit që të përpilojnë propozim për mjetet të cilat me rebalancin e Buxhetit do të destinohen për përkrahjen e tyre.

U shënua Dita e planetit Tokë

AHENG I MADH I GJELBËR NË FSHATIN PËR RICIKLIM

Qindra shkupjanë, nga të cilët më së shumti fëmijë, u mblodhën në sheshin "Maqedonia" në Shkup që të festojnë 22 prillin, Ditën e planetit Tokë. Në Fshatin për riciklim e cila u vendos në mesin e sheshit të qytetit ndodhi aksion i vërtetë i gjelbër të cilin e përkrahën nxënësit e shumë shkollave fillore të qytetit dhe të vendit. Nxënësit mblodhën shishe plastiku dhe mësuan për seleksionimin dhe riciklimin e mbeturinave nga plastiku.

Kremtimin e Ditës së planetit Tokë e organizuan Qyteti i Shkupit, USAID, Ministria për ambient jetësor dhe planifikim hapësoror dhe Ministria për ekonomi.

- Sot u mblodhëm që të festojmë ditëlindjen e planetit Tokë. Në këtë ditë kujtojmë se nuk e kemi njësoj se çka i ndodh planetit tonë, meqë ai është opsioni jonë i vetëm. Plastika në përdorim të gjerë është një kohë relativisht të shkurtër, por mbeturinat nga plastika paraqesin problem të madh pikërisht për faktin se ai nuk shpërbëhet dhe sfidon kohën. Duhet të theksohet se hedhurinat nuk janë mbeturina dhe me anë të seleksionimit dhe riciklmit ajo mund të përdoret sërish si lëndë e parë sekondare. Qyteti i Shkupit filloi me projektin për seleksionimin e plastikës, kurse përpjekjet për trajtim të drejtë të mbeturinave në qytetin tonë do të vazhdojnë

edhe më tutje – tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, para shkupjanëve të pranishëm.

Kryetari i Qyteti Trajanovski u nënshkrua edhe në Librin e gjelbër që u hap në stendën e Qytetit të Shkupit.

Ambasadori i SHBA në vendin tonë Filip Riker, nga foltorja theksoi se duhet të përkushtohemi çdo ditë për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe jo vetëm në Ditën e planetit Tokë.

- Jam i bindur thellë se ambienti i shëndetshëm jetësor është dhurata më e mirë që mund t'i lëmë gjeneratave të ardhshme. Për këtë shkak, për të gjithë ne ambienti jetësor duhet të jetë proijtoritar. Projekti i USAID për riciklimin e plastikës në Maqedoni realizohet nga viti 2005. SHBA-të përmes agjencisë USAID edhe më tej do të përkrahin projekte për mbrojtjen e ambientit në Maqedoni – theksoi ambasadori Riker.

Edhe ministri për Ambient jetësor dhe planifikim hapësoror Nexhati Jakupi theksoi rëndësinë e kujdesit të përhershëm për ambientin jetësor.

-Kjo është dita më e gjelbër. Edhe në të ardhmen do të përkushtohemi fuqishëm dhe do të punojmë për vazhdimin dhe avancimin e projekteve për seleksionimin dhe riciklimin e mbeturinave në vendin tonë – theksoi Jakupi.



Stendë me materiale informative në sheshin "Maqedonia" vendosën edhe ndërmarjet publike të qytetit, si dhe më shumë organizata joqeveritare të cilat i njoftuan qytetarët me aktivitetet e tyre në fushën e mbrojtjes së ambientit jetësor. Zbavitjen e gjelbër e pasuruan performancat e më shumë yjeve të estradës, si dhe Orkestra me mandolina, kllaunët Bidi dhe Badi, grupi i baletit të "Sumnal", fëmijët e "Super yjeve" (super xvezda) e të tjerë.

ASET E AUTOMOBILIZMIT THYEN REKORDE NË VODNO

Dyzet vozitës të vendit dhe të huaj garuan për "Çmimin e Qytetit të Shkupit", reli tradicional në automobilizëm i cili më 11 maj u mbajt rrëzë Vodnos. Kroati i njohur Franjo Kunčer shënoi rekord të ri në korsinë dhe deri në cak mbërriti për 1 minutë e 47 sekonda.

Fillimin e garës e shënoi kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski. Ai theksoi se është krenar që reli automobilistik për herë të 6-të është pjesë e kalendarit të Federatës botërore të automobilizmit (FIA) dhe që adhuruesit e këtij sporti në qytetin tonë mund të kënaqen në mjeshtëritë e kampionëve.

Gara në automobilizëm, e cila për herë të 6-të u mbajt në kalendarin e FIA është në organizim të klubit "Kastroll Primo Rejsing" dhe nën patronazh të Qytetit të Shkupit. Në auto - garat në Vodno morën pjesë garues nga Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Sllovakia, Hungaria dhe nga Kroacia.



U MBAJT KAMPIONATI SHTETËROR NË ÇIKLIZËM ALPINISTIK



Në pjerrësinë e park-pyllit "Gazi Baba" më 26 prill u mbajt kampionati shtetëror në çiklizëm alpinistik, kampionati i parë që u realizua për pikat zyrtare në konkurrencë individuale. Në kampionatin shtetëror morën pjesë 40 garues në katër kategori, në mesin e të cilëve ishin edhe garuesit nga Ambasada e Mbretërisë Holandeze dhe misionit të KFOR-it.

Fillimin e garës e shënoi Kryetari i Qytetit të Shkupit z. Koce Trajanovski i cili theksoi për rëndësinë e Qendrës rekreative – "Gazi Baba" që ka të bëjë me zhvillimin e sportit dhe rekreimit të qytetarëve që jetojnë në rrethin e tij por edhe për qytetarët e qytetit të Shkupit.

– Qyteti i Shkupit e rregulloi korsinë multidisiplinare në gjatësi prej 4,5 kilometrash vitin e kaluar në suaza të programit të tij për rregullimin e lokalitetit "Gazi Baba". Qëllimi ynë është promovimi i çiklizmit, në veçanti për gjeneratat e reja dhe njëkohësisht afirmimi i vlerave pozitive si dhe kujdesi për ambientin jetësor – theksoi Kryetari Trajanovski.



Simbolet e qytetit – Tumba Maxhari

SHTËPIA E NËNËS SË MADHE



Shtatë shtëpi dhe një tempull hapin portat e lagjes së neolitit në Tumba Maxhari të Shkupit. Lokaliteti gjendet në lagjen Çento, dhe ruan mistere për fillimet e Shkupit dhe është dëshmi për historinë e vjetër 7.000 vjeçare. Në këtë vend është zbuluar edhe terakota e njohur e Nënës së Madhe, një statuetë e vogël e cila sot është simbol i qytetit të Shkupit.

Lagjja e neolitit Tumba Maxhari është zbuluar në vitin 1962 gjatë kërkimeve arkeologjike për ndërtimin e autostradës. Sot vështirë mund të vërehet sepse dy të tretat e sipërfaqes së saj janë uzurpuar me shtëpi të ngritura në vitet gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë të shekullit të 20-të. Lagjja Tumba shtrihet në një fushë pjellore. Vendndodhja është shumë e volitshme. Nga njëra anë kodra garanton sigurinë e kërkuar para se të gjithash nga ngritja e nivelit të ujit të liqenit të Katlanovës, ndërsa nga ana tjetër kemi çdo gjë që mund të japë një natyrë e tillë: drurë, kullota, eventualisht gjueti, ndërsa në shpatet e kthyer nga dielli ara pjellore. Në një farë mënyre, lagjja ka një vendndodhje qendrore në luginën e Shkupit. Tumba Maxhari ka qenë para se të gjithash një qendër ekonomike dhe kulturore në mikrokozmosin e njeriut të periudhës së neolitit në këtë rajon. Lagjja ka formë të parregullt rrethore me diametër 220 metra dhe lartësi 3 metra.

Kërkimet e para arkeologjike janë kryer në vitin 1978 nga Muzeu i Maqedonisë, nën

drejtimin e Voislav Sanev. Janë hapur tre sonde. Rezultatet treguan bëhet fjalë për lagje neolitit, me tre faza jetese. Këtu jeta është zhvilluar në kontinuitet në periudhën ndërmjet viteve 6000–4300 p.e.r. Lagjja Tumba Maxhari përbën një qelizë protogene të Shkupit të sotshëm.

Në kërkimet e vitit 1981 është zbuluar shtëpia e parë, e përcaktuar si tempull. Deri tani janë zbuluar shtatë shtëpi, por vetëm e para është shpallur. Ajo që e bën të njohur Tumba Maxharin dhe këtë shtëpi, është statuja e vogël terakote e Nënës së Madhe. Dimensionet impulsive prej 0,39 metra lartësi, poza e qetë klasike e lindjes nga shtëpia dhe në të njëjtën kohë vigjëlmi mbi vatrën e saj dhe qetësinë, e bën këtë terakotë ekskluzive. Ajo do të jetë hallka kryesore që lidh shpirtin e njeriut të grupit kulturor të Aznabegut. Në Tumba Maxhari nga veglat janë zbuluar pesha për tezgjah vertikal, pesha bikonuse (makara) për rrjeta peshkimi, shumë shpatulla prej kocke me formë standarde, hunj dhe gjilpëra. Industria e strallit përfaqësohet nga thika stralli, prerës, havanë guri dhe mullinj.

Komuna Gazi Baba gjatë kohës së mandatit të kryetarit Koce Trajanovski në bashkëpunim me Muzeun e Maqedonisë realizuan projekt për rregullimin e këtij lokaliteti arkeologjik, sep-



se një kohë të gjatë ishte lënë pas dore për shkak të mjeteve të pamjaftueshme financiare. U ndërtuan dy shtëpi dhe objekte ndihmëse për vizitorët. Objektet u ndërtuan me material ndërtimi origjinal, me shpirtin dhe stilin e arkitekturës të kohës së gurit të hershëm – neolit. Përveç pastrimit të lokalitetit, komuna Gazi baba financoi ndërtimin e rrugës, parkingut dhe rrethimin e hapësirës. Gjithashtu, u përgatitën broshura dhe material propagandistik, me të cilën ky lokalitet u fut në kornizat e evenimenteve kulturore në qytetin e Shkupit dhe në Maqedoni, si vend turistik kulturor atraktiv.

Në internet faqen e qytetit

INFORMACIONE TË RREGULLTA PËR PRANINË E POLENIT NË AJËR

Në ueb faqen e Qytetit të Shkupit, www.skopje.gov.mk, çdo të mërkurë në 12 muajt e ardhshëm do të shpallen të dhëna për praninë dhe koncentrimin e llojeve më të rëndësishme të alergjenëve në ajër. Me një klikim në linkun, shkupjanët do të mund të lexojnë analizë detale për koncentrimet e polenit për javën e ardhshme. Ky aktivitet është pjesë e projektit "Zvogëlim i prevalencës të alergjive dhe ndjekja e alergogjenëve dhe taksonëve invaziv në qytetin e Shkupit". Projekti është përkrahur nga Qyteti i Shkupit dhe është në realizim të organizatës joqeveritare "Aksioni femëror" (Zhenska akcija).

Sëmundjet alergjike sot paraqesin problem të madh shëndetësor në gjithë botën, veçanërisht në qendrat e mëdha urbane dhe tek ne tregojnë tendenca rritëse. Farat e polenit të cilat janë bartëse të cilësive alergogjene, janë shkaktare të polenozit, të cilat më së shumti janë manifestuar si riniti alergjik, astma, konjuktiviti dhe urtikaria. Në Republikën e Maqedonisë prevalenca e sëmundjeve alergjike është llogaritur në 35,6 përqind. Parashikohet se kjo përqindje është më e madhe, veçanërisht në periudhën e sezonit të polenit, kur incidenca mujore në shkresë e ambulancave është mbi 80 përqind.

Detyra kryesore e këtij projekti është të bëjë hap serioz në politikën shëndetësore, me atë që do të ndjekë dhe vlerësojë të dhënat dhe informacionet dhe do të informojë opinionin për praninë e polenit në ajër.

Projekti "Zvogëlim i prevalencës të alergjive dhe ndjekja e alergogjenëve dhe taksonëve invaziv në qytetin e Shkupit", realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat qytetare "EKG", Këshilli i Evropës, "Plimont" dhe Instituti për medicinë të punës të Republikës së Maqedonisë.

Analizat aeropolinologjike të cilat do të shpallen në internet faqen www.skopje.gov.mk i realizon mjeku i shkencave biologjike Snezhana Milkovska, agrobiologu i vetëm në Republikën e Maqedonisë.



Qytete të vëllazëruara - Lubjana

PORTA E EVROPËS QENDRORE DREJT MESDHEUT

Në kërkim të portës të Evropës Qendrore drejt Mesdheut rruga na çon drejt Lubjanës, kryeqytetit dhe qytetit më të madh të Sllovenisë. Në të jetojnë 270.000 banorë, por Lubjana posedon të gjitha karakteristikat e një metropoli duke ruajtur në të njëjtën kohë atmosferën miqësore karakteristike për qytet e vogla. Si qytet i gjelbërimit ai është i mbushur me parqe dhe sipërfaqe të gjelbra. Është shtëpi e shumë muzeve, teatrove dhe galerive, dhe në të punon edhe një nga orkestrat filarmonike më të vjetra në botë. Vendndodhja e Lubjanës është një pikë ideale fillestare për vizitë në bukuritë natyrore nëpër Slloveni. Lubjana sot padyshim përfaqëson qytet me kualitet të lartë të jetës.

Kryeqyteti i Sllovenisë gjendet në pjesën qendrore të shtetit, në të ashtuquajturën luginë e Lubjanës, ndërmjet Alpeve dhe Detit Adriatik, të lumit Lubjanica afërsisht 10 km nga derdhja e Savës. Qyteti është i ndarë në disa kuarte, komuna të mëparshme. Lubjana është qendër poli-

tike, administrative, ekonomike, kulturore dhe shkencore e Sllovenisë.

Ekzistojnë disa interpretime historike për origjinën e emrit Lubjana. Sipas të parave, origjina duhet të kërkohej në fjalën "Lublana", të tjerë mendojnë se ka të bëjë me perëndinë e vjetër Laburus, të tretët mendojnë se fjala vjen nga shprehja latine për lum që përmyt: aluviana, përderisa disa të tjerë mendojnë se vjen nga fjala gjermane Laibach – përrua qumështi. Simboli i qytetit është dragoi i Lubjanës.

Pozicioni gjeografik i Lubjanës, duke pasur parasysh se gjendet në kalimin natyror të quajtur "Porta e Lubjanës" që të çon nga Evropa Qendrore drejt Mesdheut dhe drejt Lindjes nëpërmjet së cilës nëpër shekuj kanë kaluar rrugë tregtare dhe dallgë emigracioni, si dhe ndikimi i kulturës Gjermane, Sllovene dhe Latine në këtë rajon determinojnë të kaluarën e pasur historike kulturore. Nga kohët e popullimeve të para deri në ditët e sotme, karakteri transit i këtij rajoni stimulon rritjen konstante të lidhjeve ekonomike dhe kulturore me qytetet dhe kombet e tjera. Për këto arsye,

ekonomia e këtij qyteti pothuajse gjithmonë ka qenë heterogjene, duke mundësuar adaptimin e shpejtë me ekonominë e ndryshueshme botërore.

Lubjana në vete bart harmoninë e tërësive, ku ndërthuret e vjetra me të rene, tradita dhe pasuria kulturore dhe mënyra moderne e jetesës, me respektimin e vlerave të përbashkëta që qytetit i jep pamje të veçantë.

Lubjana është vëllazëruar me 23 qytete nga e gjithë botën ndërmjet të cilëve edhe me qytetin e Shkupit.



QYTETI I SHKUPIT**KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT**

KOCE TRAJANOVSKI
tel: 32 97 204
gradonacalnik@skopje.gov.mk
baraka nr: 4

SEKRETARI I QYTETIT TË SHKUPIT

IRENA MISHEVA
tel: 32 97 207
irena.miseva@skopje.gov.mk
baraka nr: 1

SEKTORI PËR FINANCA

Drejtues: KRSTE ANDONOVSKI
tel: 32 97 277
kandonovski@skopje.gov.mk
baraka nr: 7

SEKSIONI PËR PËRCAKTIMIN DHE PAGIMIN E TATIMEVE, TAKSAVE DHE KOMPENSIMEVE TJERA

tel: 32 97 280 - tatim dhe dhurata
tel: 32 97 316 - pronë
tel: 32 97 314 - taksa
danoci@skopje.gov.mk

SEKTORI PËR MBROJTJEN E AMBIENTIT JETËSOR DHE TË NATYRËS

Udhëheqës: ALJOSHA SHOPAR
tel: 32 97 282
Aljosa.Sopar@skopje.gov.mk
baraka nr: 10a

SEKTORI PËR PUNËE KOMUNALE

Udhëheqës: CVETANKA IKONOMOVA-MARTINOVSKA
tel: 32 97 301
Cvetanka.Ikonomova@skopje.gov.mk
infoekologija@skopje.gov.mk
baraka nr: 14

INSPEKTORAT I QYTETIT TË SHKUPIT

Drejtues: HAMZI XHAFFERI
tel: 32 97 359
hamzidz@skopje.gov.mk
baraka nr: 14

NDËRMARRJET PUBLIKE**NP „PARKINGU I QYTETIT“**

Drejtues: LJUPÇO JOVANOVI
jovanovlj@gradskiparkig.com.mk
tel: 30 91 072, 30 91 074
www.gradskiparking.com.mk
- Shërbimi i merimangës
tel: 32 38 871

NP „RRUGË DHE RRUGICA“

Drejtues: ILIJA MARTINOVSKI
tel: 31 62 317
www.jpulicipatista.com.mk
NP „SHKUP“

Drejtues: ALEKSANDAR BOSHKOVIC
aboskovic@jsp.com.mk
tel: 31 74 265
www.jsp.com.mk

- Qendra e dispeçerisë
tel: 31 73 224

NP „HIGJIENA KOMUNALE“

Drejtues: Zlatko Dimovski
tel: 32 20 827
www.khigiena.com.mk

NP „PARQET DHE GJELBËRIMET“

Drejtues: DUSHAN AVIROVIQ
tel: 30 70 112

NP „UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI“

Drejtues: IGOR ARNAUDOV
tel: 32 20 839
www.vodovod-skopje.com.mk

-RAJONET PËR PAGESË DHE MIRËMBAJ-TJE TË RRJETIT TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT

Rajoni 1 Qendër

pagesa tel: 31 17 753
reoncentar@vodovod-skopje.com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 32 38 992
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 31 37 123

Rajoni 2 Kisela Voda

pagesa tel: 31 16 987
reonkiselavoda@vodovod-skopje.com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 27 82 609
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 27 91 566

Rajoni 3 Karposh

pagesa tel: 31 18 581
reonkarpos@vodovod-skopje.com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 30 76 407
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 30 62 174

Rajoni 4 Çair

pagesa tel: 31 17 673
reoncair@vodovod-skopje.com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 26 71 888
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 26 71 999

Rajoni 5 Gazi Babë

pagesa tel: 31 16 889
reongazibaba@vodovod-skopje.com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 31 74 524
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 31 74 524

INSTITUCIONET KULTURORE TË QYTETIT

BIBLIOTEKA „VËLLEZËRIT MILLADINOV“
31 62-544
QENDRA INFORMATIVE KULTURORE 31 15-238
SHTËPIA E KULTURËS „KOÇO RACIN“
31 63-739
QENDRA KULTURORE RINORE
31 15 508
MUZEUMI I QYTETIT TË SHKUPIT
31 15-367; 31 13-609
SALLA UNIVERZALE - SHKUPIT 3245615
KOPSHTI ZOOLOGJIK 32 20-578
QENDRA KULTURORE E FËMIJËVE
„KARPOSH“ 31 16 159

NUMRAT MË TË RËNDËSËSHËM

- Shërbimi i zjarrfikësve 193
- Qendra për menaxhimin me krizat 195
- Elektro-Shkup 02 31 61 454
- Ujësjiellësi dhe kanalizimi 02 30 73 010
- Higjiëna komunale 02 32 24 961
- Ngrohtorja 02 30 76 200
- NQP „Shkup“ orari i vozitjeve 02 31 73 224
- Stacionari Vardarishte 075 50 60 90
- Qendra urgjente 02 31 47 147
- Spitali i qytetit 02 31 30 311
- Barnatore kujdestare „Zegin“ 02 32 98 504
- Aeroporti „Aleksandar Makedonski“
02 31 48 333; 02 31 48 336
- Stacioni ndërkombëtarë i autobusëve
02 24 66 011; 02 24 66 313
- Stacioni hekurudhor 02 31 64 255
- Shërbimi amë - DQPM
31 17 037; 31 17 766
- Salla e kurorëzimeve 31 18 250
- Inspektorati republikan i tregut 975
- SOS - gjendjet e krizës për fëmijët dhe të rinjtë 0800 12 222; 31 36 400
- SOS - për gratë dhe fëmijet viktimë të dhunës 9700
- SOS - informata dhe parandalimi i tregtisë me njerës 0800 11 111; 31 73 424
- Kinematë e qytetit - Shkup 31 37 377
- Kinemaja Ramstor 32 90 153
- Kinemaja Milenium 31 20 389
- Teatri dramatik 30 63 388
- Qendra teatrale e fëmijëve 32 90 111
- Opera dhe baleti maqedonas - OBM
31 14 511
- Galeria kombëtare e - Stacioni i vogël
31 26 856

KOMUNAT E SHKUPIT

- Komuna Qendër 3203 680
- Komuna Kisela Voda 2785 400
- Komuna Aerodrom 2400 970
- Komuna Karposh 3061 507
- Komuna Gazi Babë 3226 655
- Komuna Çair 2616 865
- Komuna Butel 2616 868
- Komuna Shuto Orizare 2650 584
- Komuna Gjorçe Petrov 2039 307
- Komuna Saraj 2050 289



I ♥ Skopje



БАСКЕРФЕСТ

СКОПЈЕ 2009

29 МАЈ - 9 ЈУНИ



ДЕНОВИ НА
ЈУСТИНИЈАН I
11-24 мај '09

skopje jazz festival presents



EUROPEAN
FORUM OF
WORLDWIDE MUSIC
FESTIVALS



Универзална сала **28 МАЈ**

LILA DOWNS

MEXICO

Универзална сала **30 МАЈ**

RUNDEK CARGO TRIO

CROATIA/France

MELINGO

ARGENTINA

МОБ **02 ЈУНИ**

LJUBOJNA

MK

PROJECT ZLUST

МОБ **04 ЈУНИ**

ORIENT EXPRESSIONS

TURKEY

BABA ZULA

Универзална сала **10 ЈУЛИ**

PATTI SMITH

USA

AND HER BAND

ДОКУМЕНТАРНИ ФИЛМОВИ

29 МАЈ Кинотека на Македонија **PATTI SMITH: DREAM OF LIFE**

3 ЈУНИ Кинотека на Македонија **CROSSING THE BRIDGE: THE SOUND OF ISTANBUL**

www.offest.com.mk



Медиумски спонзори: КАНАЛ 5, ТЕЛМА, АЛФА, АЛСАТ, K-15, АНТЕНА 5, КАНАЛ 103, РАДИО РАВЕЛ, ДНЕВНИК, УТРИНСКИ ВЕСНИК, ВЕСТ, ГЛОБУС, ТЕА МОДЕРНА, ФОРУМ, КАПИТАЛ.

БИЛЕТИ ВО ПРОДАЖБА ВО: ЈУГОТОН, ЧУВ ДЕ ЧУВ, УНИВЕРЗАЛНА САЛА

Kiliping